

orësh u nisën për në qytet. Përderisa prisnin për autobus në **Mulliq/Molić**, ka ardhur një *Pinzgauer* me ushtarët serb, i cili e ka shkelur Dritonin. Ushtarët e kanë bartur djalin në spitalin e Pejës/Peć. Haliti dikush i kishte lajmëruar çfarë kishte ndodhur dhe ai u nis në vendin e ngjarjes. Atje e kishte gjetur policinë rrugore duke i kryer hetimet në vendngjarje, ndërkaq Dritonin e kishin dërguar në spital. Po atë ditë, Haliti ka mësuar se Dritoni kishte ndërruar jetë nga plagët e marra. E kanë varrosur më 11.12.1998 në varrezat e Nivokazit/Nivokaz.

Burimet: deklarata H.Z, FDH-40625; J. Osmani, *Krimet...*, I, 306.

Ukë (Haxhi) Mustafa

(15.01.1948, shqiptar nga Babaji i Bokës/Babaj Boks, komuna e Gjakovës/Đakovica, elektrikist, pesë fëmijë

Uka i siguronte të ardhurat nga puna private me instalime të rrymës. Në datën **11.12.1998**, serbët nga fshati Korenicë/

Korenica e ftuan me telefon, për të shkuar atje për një intervenim në rrjetin elektrik. Vetëm dy ditë më herët, ai kishte qenë në Korenicë/Korenica për një intervenim të tillë. Shkoi atje herët në mëngjes. Nuk u kthye më. Bashkëshortja dhe fëmijët e kishin pritur tërë natën që të kthehej. Mendonin se e kishte çuar ndonjë gotë më tepër dhe se ka mbetur te ndonjëri, për të kaluar natën. Të nesërmen, djali Atdheu dhe vajza Arbnora dolën jashtë shtëpisë, por u kthyen menjëherë duke thënë se e kishin parë trupin e pajetë të babait në fushën e afërt. Bashkëshortja shkoi menjëherë atje dhe u bind se fëmijët e kishin thënë të vërtetën. Pas pak, ka ardhur policia. E kanë marrë trupin e Ukës dhe e kanë çuar në morgun e Gjakovës/Đakovica. Katër ditë më vonë, komshinjtë e kanë marrë trupin e Ukës nga morgu. Po atë ditë, e kanë varrosur në varrezat e **Babaj të Bokës/Babaj boks**.

Burimet: deklarata B.M, FDH-29020; KKMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832.
